



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC

Adresa: Lagja nr.1 Roskovec.web:www.bashkiaroskovec.gov.al.nr.tel:0387 80242

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE
PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN
CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE
(Specialist)**

**Lloji i diplomës “Drejtesi”
niveli minimal i diplomës “Diplome Bachelor”**

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM-së Nr.142 datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicionëve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar ; si dhetë Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave(I ndryshuar) **Bashkia Roskovec** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

- ❖ 1(nje) jurist ne Drejtorine e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit, Bashkia Roskovec
- ❖ 1(nje) jurist ne Drejtorine Juridike dhe Burimeve Njerezore, Bashkia Roskovec
- ❖ 1(nje) jurist ne Drejtorine e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural, Bashkia Roskovec Roskovec
- ❖ 1(nje) jurist ne Drejtorine e Sherbimeve, Bashkia Roskovec

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil të së njëjtes kategori në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil. Nëse nuk ka një fitues nga procedura e levizjes paralele, plotësimi i vendit vakant do të realizohet me procedurën e Pranimit në shërbimin Civil.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe Pranimë Shërbimin Civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

- **Afati për dorëzimin e dokumentave për**

LEVIZJE PARALELE: 04.04.2019

- **Afati për dorëzimin e dokumentave për**

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 09.04.2019

DETYRAT

Specialiti përgjigjet tek Përgjegjësi i Sektorit, për zbatimin e politikave, strategjive dhe planeve të fushës përkatëse, si dhe për sigurimin e mbarëvajtjes së punës së Sektorit në përputhje me ligjet, aktet nënligjore apo aktet rregullatore në fuqi

Detyrat Kryesore

- Realizon detyrat në bazë të ndarjes së brendshme të nga Drejtori i Drejtorisë.
- Ndjek në Gjykatë sipas rastit çështjet gjyqësore në të cilat Bashkia është palë.
- Përgatit përgjigjet për kërkesat e shtetasve dhe institucioneve të ndryshme.
- I jep ndihmë juridike Drejtorive dhe sektorëve të Bashkisë për përgatitjen e akteve të ndryshëm.
- Ndiemon në përgatitjen e kontratave ose marrëveshjeve në të cilat Bashkia Roskovec ose institucionet e varësise janë palë.

I. Levizja Paralele

Kjo procedurë është e hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë:

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda të njëjtës kategori.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
3. Të ketë të paktën vlerësim e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

Kriteret e vecanta për këto pozicion janë:

- a. të zoterojë diplome minimumi 3-vjecare , Diplomë “Bachelor”, në Degën “Drejtesi”. Nëse diploma është marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi
- b. të ketë të paktën 1 vit punë.
- c. Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj;

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njërëzore, të Bashkisë Roskovecs, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njësuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje e vlerësimit të fundit vjetor.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore.

Dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen deri më datë **04.04.2019**.

Rezultatet nga verifikimi paraprak të kushteve minimale të procedurës së lëvizjes paralele dhe të përmbushjes së kriterëve specifikë të vendit të punës do të dalin në datën **08.04.2019**. Nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Sherbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Internetit të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut portalin “Sherbimi Kombëtar i Punësimit”,

- në faqen zyrtare të Internetit të Bashkisë
- në stendën e informimit te publikut.

Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njërëzore, për shkaqet e moskualifikimit në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak të kandidatëve.

Ankesat nga kandidatet paraqiten ne Njesine pergjegjese te menaxhimit te Burimeve Njërëzore, brenda 3 diteve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr pergjigje brenda 5 diteve kalendarike nga data e perfundimit te afatit te ankimeve.

Pas perfundimit te procedures se siperpermendur nepunesi me i larte civil i institucioniot bnrenda dy diteve kalendarike urdheron ngritjen e komisionit te brendshem.

Komisioni i brendshem brenda 2 (dy) diteve kalendarike nga data e krijimit te tij, zhvillon intervisten me goje.

Intervista me goje do te zhvillohet ne ambjentet e Bashkise Roskovec më datë **19.04.2019 ora 11:00.**

Në intervistë kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.8652 dt.31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar.
- Ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe aktet nenligjore e dala per zbatim te tij.
- Kodi i Punes i Republikes së Shqiperise;
- Kodin e Procedurave Administrative
- Kodi Civil
- Kodi i Proçedurës Civile
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Njohjen e kërkesave te Rregullores së Brendëshme, e Kodin e Etikes të miratuar nga Këshilli Bashkiak Patos.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele ngritur në Bashkin Roskovec**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për çertifikimin pozitiv.
- b. **60 pikë** për intervistën me gojë;

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, rendit kandidatet sipas pikeve të grumbulluara dhe i dërgon listën nënjesore të burimeve njerezore të institucionit. Njesia e burimeve njerezore e institucionit, brenda 24 orëve nga dita që komisioni i njofton vendimin e tij, njofton individualisht kandidatet që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatet, pavarësisht nga drejta për të ankuar kanë të drejtë të bëjnë ankime me shkrim dhe në komisionin e brendshëm për lëvizjen paralele për rezultatin e vlerësimit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit.

Komisioni më **date 22.04.2019** njofton për vendimin e përzgjedhjes, Njesinë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerezore.

Njesia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, me date **29.04.2019** shpall fituesin.

Njoftimi do të bëhet:

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” ,
- në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec
- stenden e publikimeve të Bashkisë Roskovec.

II- Pranimi në Shërbimin Civil.

Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele nuk ka fitues, plotësimi i vendit vakant do të realizohet nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil në kategorinë e kzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar:

Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar(hequr) sipas këtij ligji.

Kriteret e veçanta për këtë pozicion janë:

- a) të zotërojnë minimumi Diplomë “Bachelor”, në Degën Juridike.. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- b) të ketë deri në 1 vit punë.
- c) Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj;

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorisë Juridike së Burimeve Njërezore, të Bashkisë Roskovec, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.

- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës.Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave.Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore.

Rezultatet nga verifikimi paraprak të kushteve minimale të procedurës së pranimit në shërbimin civil dhe të përmbushjes së kriterëve specifikë të vendit të punës do të dalin në datën **23.04.2019** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen e Internetit të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

- Gjithashtu, po në këtë datë kandidatët që nuk janë kualifikuar do të njoftohen nga Njësia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, për shkaket e moskualifikimit.
- Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësine Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerezore brenda 5 ditëve kalendarike nga dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit e afatit të ankimit.
- Konkurimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë, do të zhvillohet në ambjentet e Bashkisë Roskovec më datë **07.05.2019 ora 10:00.**

Në konkurimin me shkrim dhe intervistë e strukturuar me gojë, kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.8652 dt.31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore" i ndryshuar.
- Ligjin 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe aktet nenligjore e dala për zbatim të tij.
- Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë;
- Kodin e Procedurave Administrative

- Kodi Civil
- Kodi i Proçedurës Civile
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Njohjen e kërkesave të Rregullores së Brendëshme, e Kodin e Etikes të miratuar nga Këshilli Bashkiak Patos.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen nga Komisioni i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkisë Roskovec.

Totali i pikeve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pike të cilat ndahen përkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist*”.

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, të kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë, 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorin ekzekutive”.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pra më **date 08.05.2019** I ve në dispozicion listen e fituesve, Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerezore.

Njesia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, me **date 20.05.2019** shpall listen e fituesve.

Njoftimi do të bëhet:

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”
- në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec
- në stenden e informimit publik të Bashkisë Roskovec.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne adresen Bashkia Roskovec.

e-mail : *oltaristani@yahoo.com*

nr.tel: **0387 80242.**

NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE

Bashkia Roskovec